



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.20, datë 16.01.2023

PËR

“CAKTIMIN E DATËS SË SEANCËS DËGJIMORE NË PROCEDIMIN
DISIPLINOR NË NGARKIM TË MAGJISTRATIT

Bazuar në nenin 138, pika 2, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164, pika 8, 189, pika 1, germa “a” dhe 190, pikat 1 dhe 2, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe nenin 25, pika 1, të Rregullores “Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve”, me propozimin e Komisionit Disiplinor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Caktimin e datës 30.01.2023, ora 12:00, për zhvillimin e seancës dëgjimore për procedimin disiplinor Nr.2200/1, datë 27.12.2022, filluar me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj magjistratit _____, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor _____
2. Ky vendim i njoftohet menjëherë magjistratit _____ dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet i anonimizuar në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 16.01.2023.

KRYETAR

Alfred Balla

